



Pranuar / Dorezuar Priljena/Pridata Received/Delivety	22.06.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHUK	4878/2023		116



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.753/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi -Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.753/2023 të datës 18.05.2023 të parashtruar nga ankuesi ne adresë banimi: kundër Vendimit me numër KD.nr.20/2023 i datës 11.05.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "Masë Disiplinore" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 22.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.753/2023 e datës 18.05.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi me numër KD.nr.20/2023 i datës 11.05.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesit i cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datë 18.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me Numër Prot:4325/2023, kundër Vendimit me numër KD.nr.20/2023 i datës 11.05.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ankesë e cila është plotësuar përmes parashtrësës së datës 22.05.2023 me shifër 753/2023.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore dhe zhvillimit të procedurës disiplinore ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e aplikuara ligjore të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative, ka zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material si dhe ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me kërkesën që Këshilli të aprovojë ankesën e ankuesit si të bazuar ndërsa të anulojë Vendimi e datës 10.03.2023 me numër KD.nr.07/2023 të Komisionit Disiplinor.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues i Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 26.05.2023 ka pranua nga Shërbimi Korrektues i Kosovës përgjigjen në kërkesë, së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.prot:4325/2023 të datës 18.05.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër KD.nr.20/2023 i datës 11.05.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Parashtresën e datës 22.05.2023; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore të datës 05.04.2023; Raportin e datës 13.04.2023 lidhur me refuzimin e urdhrit të Drejtorit nga ankuesi; Raportin e datës 12.04.2023 lidhur me refuzimin e urdhrit të Drejtorit nga ankuesi; Raportin e datës 05.04.2023 në lidhje me refuzimin e urdhrit të Drejtorit nga ankuesi; Raportin nga konsulta mjekësore të datës 05.04.2023; Raportin për zgjatjen e paftësisë së përkohshme në punë i datës 05.04.2023; Kërkesën e ankuesit të datës 05.04.2023 lidhur me mungesën në punë; Kontratën e ankuses të datës 02.07.2018; Kërkesën e ankuesit të datës 13.04.2023; E-mailin e datës 23.05.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 26.05.2023; Përshkrimin e detyrave të punës i datës 03.01.2020; Ftesën për intervistë të datës 14.04.2023; Flete kthesën e datës 12.05.2023; Procesverbalin e intervistës së datës 14.04.2023 për zyrtarin Sh.K; Procesverbalin e intervistës së datës 18.04.2023 për zyrtarin Sh.K; Vendimi për themelimin e Komisionit Disiplinor i datës 05.05.2023; Akt emërimit e datës 24.01.2023; Vendimin e datës 15.12.2022 me shifër:1333 të Zëvendësuesit të Drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Akt emërimit e datës 13.01.2017; Vendimin e datës 15.12.2022 me shifër:1335 të Zëvendësuesit të Drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Kontratën e punës së zyrtarit K.H të datës 15.08.2019; Vendimin e datës 02.05.2023 të Kryesuesit të Komisionit Disiplinor.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa A.nr.753/2023 e datës 18.05.2023 e parashtruar nga ankuesi është e bazuar, sepse:

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi sipas kontratës së punës të datës 02.07.2018 ka të themeluar marrëdhënien e punës pranë Shërbimit Korrektues të Kosovës në pozitën "Mbikëqyrës në Qendrën e Paraburgimit në Prizren", ndërsa ndaj të njëjtit me datë 05.04.2023 Zëvendësuesi i Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prizren ka iniciuar procedurën disiplinore me pretendimin se i njëjti ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 të Ligjit për Zyrtarët Publik dhe nenit 58 paragrafi 3.12 të Ligjit për Shërbimin Korrektues të Kosovës, pasi që i njëjti nuk e ka zbatuar urdhrin e dhënë me qëllim të ushtrimit të detyrës së Mbikëqyrësit të Lartë.

Kolegji i Këshillit ka gjetur se Kryesuesi i Komisionit Disiplinor pas pranimit të kërkesës për iniciimin të procedurës disiplinore, përmes shkresës së datës 14.04.2023 e ka ftuar ankuesin në intervistën e planifikuar të datës 18.04.2023, ndërsa edhe iniciuesi i procedurës disiplinore ishte ftuar paraprakisht në seancën e datës 14.04.2023 të Komisionit Disiplinor. Tutje, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues përmes vendimit me numër:663 e ka ndryshuar përbërjen e Komisionit Disiplinor, pasi që kryesuesi paraprak i Komisionit Disiplinor gjegjësisht zyrtari H.M e ka arritur moshën e pensionimit ndërsa në vend të tij caktohet zyrtari K.H, kurse dy anëtarë e tjerë të Komisionit mbesin të njëjtit, A.V dhe M.S, ndërsa me datë 11.05.2023 Komisioni Disiplinor nxjerrë Vendimin KD.nr.20./2023 përmes të cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Ulje në pozitë" të përcaktuar me nenin 59 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, me arsyetimin se i njëjti është përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara nenin 58 paragrafi 3 pika 3.12 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Me Ligjin Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020 përkatësisht me nenin 4 paragrafi 1 është përcaktuar se: "*Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë*", nga rrjedh se me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, themelimi, ndryshimi, përfundimi i marrëdhënies së punës si dhe çdo e drejtë dhe detyrim nga marrëdhënia e punës për zyrtarët e shërbimit korrektues i nënshtrohet dispozitave të legjislacionit për nëpunësit civil dhe ligjeslicaionit të veçantë, gjegjësisht me ligj të veçantë ndryshe mundë të rregullohen ndryshe vetëm çështjet e përcaktuara sipas dispozitave të nenit 4 paragrafi 2 Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: "**2. Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës:** 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve", nga rrjedh zyrtarëve publik të punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës e të cilët e kanë statusin e nëpunësit civil, nuk mund t'u shqiptohet ndonjë masë tjetër disiplinore përveç masave të përcaktuara me nenin 47 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, sikurse janë përcaktuar: "**1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë:** 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil", ngase për çështje të tilla Ligji Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë është ligj bazikë sikurse në rastin konkret, prandaj pretendimi ankimor i ankuesit se Komisioni Disiplinor ka zbatuar gabimisht dispozitat e legjislacionit në fuqi është pretendim i bazuar, ngase masa e disiplinore "Ulje në pozitë" e shqiptuar ndaj tij nuk është masë disiplinore e përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me shkeljet esenciale të procedurës së zhvilluar ndaj tij nga ana e Komisionit Disiplinor, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 48 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: "*Procedura administrative disiplinore garanton të drejtën e nëpunësit për t'u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t'u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova, të drejtën për të pasur qasje në dokumente që lidhen me procedurën, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t'u asistuar, si dhe të drejtën për t'u ankuar ndaj vendimit përfundimtar.*

Nëpunësi civil mund të ndihmohet gjatë procedurave disiplinore nga një përfaqësues i sindikatës ku bën pjesë, nga një avokat apo nga një përfaqësues i nëpunësve civilë të institucionit, nëse nuk është anëtar i një sindikate” dhe ka ardhur në përfundimin se ankuesi përmes shkresës së datës 14.04.2023 është ftuar në cilësi të dyshuarit për shkelje disiplinore në seancën e parashikuar të datës 18.04.2023, mirëpo i njëjti nuk është udhëzuar apo njoftuar se në seancën e datës 18.04.2023 mund të shoqërohet nga një avokat apo nga një përfaqësues i nëpunësve civilë të institucionit nëse nuk është anëtar i një sindikate, nga rrjedh se Komisioni Disiplinor ka kryer shkelje procedurale pasi që nuk ka vepruar sipas detyrës zyrtare sikurse parashihet me nenin 48 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë.

Po ashtu, duke marrë për bazë përcaktimet ligjore të nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 12 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.2 dhe 3.4 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku shprehimisht rregullohet se: “1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura; 3. Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: 3.1. Merr në pyetje ose merr deklarata nga dëshmitarët dhe verifikon faktet; 3.2. Rishikon dokumentacionin përkatës; 3.4. Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për verifikimin e ngjarjes”, Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se Komisioni Disiplinor nuk ka shqyrtuar të gjitha faktet dhe rrethanat e paraqitura, dhe nuk ka ndër marrë edhe veprime të tjera sipas kompetencave ligjore me qëllim të verifikimit të ngjarjes dhe pretendimeve ankimore të ankuesit, ngase sipas nenit 32 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues paragrafi 1 përcaktohet se: “1. Personeli i SHKK-së është i detyruar të zbatojë urdhrat e dhënë nga eprorët sipas shkallës funksionale dhe sipas hierarkisë së gradës. Urdhrrat duhet të jepen në përputhje me detyrën funksionale si dhe të mos jenë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.”, kurse iniciuesi i procedurës disiplinore sipas arsytimit të vendimit të Komisionit Disiplinor dhe procesverbalit të datës 14.04.2023, citoj: “Mbikëqyrësi me datë 05/04/2023 në ora 06:45 minuta përmes telefonit zyrtar i kishte telefonuar zëvendësuesit të Drejtorit z. duke e njoftuar se nuk mundet ta pranoi detyrën e Mbikëqyrësit të Lartë.....

kategorikisht kishte refuzuar që ta pranoi detyrën dhe Përgjegjësitë e ushtruesit të detyrës së Mbikëqyrësit të Lartë”, nga rrjedh se urdhri i dhënë nuk është në përputhje me detyrën funksionale, ngase ankuesi sipas Kontratës së punës e ka pozitën Mbikëqyrës, ndërsa urdhri i dhënë i referohet detyrave funksionale për pozitën Mbikëqyrës i Lartë, sikurse Komisioni Disiplinor nuk ka mundur ta arsyetoj me prova konstatimin e dhënë në vendimin e marr dhe as me provat e ofruara me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese, se ankuesi ka pasur ndonjë urdhër përpara datës 05.04.2023 apo përpara orës 06:045 të së njëjtës datë nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prizren apo nga ndonjë epror tjetër më i lartë, ngase sipas deklarimeve të vetë iniciuesit të procedurës disiplinore por edhe të deklarimeve të ankuesit në seancën e datës 18.04.2023 konstatohet fakti se ankuesi ishte ai që e ka telefonuar Zëvendësuesin e Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prizren me qëllim të njoftimit me situatën e krijuar, sikurse Komisioni Disiplinor duhet ta ketë pasur parasysh apo konstatoi deklarin e iniciuesit të procedurës disiplinore në seancën e datës 14.04.2023 se mbi çfarë baze apo dispozite ligjore të ligjit të veçantë, aktit nënligjore apo rregullores së brendshme caktohen zëvendësuesit apo ushtruesit e detyrës në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, dhe nëse kjo çështje është e rregulluar, pse iniciuesi i procedurës disiplinore apo Zëvendësuesi i Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prizren në rastin konkret nuk ka ofruar asnjë provë përmes të cilës do të dëshmonte faktin se ankuesi është ngarkuar me përgjegjësi të zëvendësuesit të Mbikëqyrësit të Lartë, pasi që Mbikëqyrësi i Lartë kujdestar nuk kishte qenë në punë atë ditë për shkak të obligimeve familjare dhe se sipas dispozitave të nenit 32 paragrafi 4 të Ligji Nr.06/L-114 Zyrtarët Publikë ndërlidhur me nenin 18 paragrafi 5, nenin 19 paragrafi 4 dhe nenin 20 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura përcaktohet mënyra e



caktimit të zëvendësuesve, sikurse zëvendësimi duhet të behët përmes vendimit apo aktit administrativ në formë të shkruar.

Komisioni Disiplinor po ashtu me rastin e shqyrtimit të masës disiplinore nuk ka marr përbazë deklaratimet e ankuesit në seancën e mbajtur disiplinore të datës 18.04.2023, i cili ndër të tjerash deklaroi se nuk qëndrojnë pretendimet e inicuesit të procedurës disiplinore dhe as deklaratimet e zyrtarit S.M sipas deklaratës apo raportit të datës 12.04.2023 se unë e kam refuzuar urdhrin, madje një e gjë e tillë mund të dëshmohet me verifikimin e pamjeve apo incizimet e kamerave të sigurisë dhe formularëve të nënshkruar, ngase citoj ankuesin: *"Gjatë asaj kohe i kam plotësuar mungesat e stafit nëpër vende pune në cilësinë e Mbikëqyrësit të Lartë, pastaj e kam vizituar oficerin korrektues në "karakoll" pikë vrojtuese njëherit është kontrolluar arma MP5 dhe municioni dhe pastaj është nënshkruar nga unë në cilësinë e Mbikëqyrësit të Lartë si dëshmi që kam punuar dhe nuk bëhet fjalë për refuzim të urdhrin. Pastaj i kam vizituar të gjitha vendet e punës në pjesën banueses të nënshkruara formularët nëpër krihet A, B, C, D të pavijonit si Ud. Mbikëqyrësit të Lartë dhe i kam marr nga kutia kërkesat e të burgosurve për ti proceduar më tutje, këtë e dëshmojnë edhe me shqimin e kamerave të datës 05.04.2023",* prandaj Kolegji i Këshillit vlerëson se Komisioni Disiplinor nuk ka vepruar sipas obligimeve ligjore që rrjedhin nga 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 12 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.2 dhe 3.4 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ngase nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret me qëllim të shqyrtimit dhe verifikimit të fakteve apo verifikimin e ngjarjes qoftë përmes shikimit të kamerave apo verifikimit të formularëve për të cilët pretendon ankuesi se i ka nënshkruar, dhe tek pas verifikimit të këtyre veprimeve për të cilat ankuesi pretendon t'i ketë ndërmarr në cilësi të Mbikëqyrësit të Lartë, pastaj Komisioni Disiplinor do të kishte konstatuar saktë gjendjen faktike se ankuesi nuk ka vepruar sipas konsultave apo bisedës së realizuar me datë 05.04.2023 të orës 06:45 me Zëvendësuesin e Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prizren.

Ankuesi po ashtu, me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill, ka ofruar dëshmi se me datë 05.04.2023 i ishte drejtuar me kërkesë Drejtorisë së Qendrës së paraburgimit që ta lirojnë nga detyra prej orës 11:15 minuta, kërkesë kjo e cila është provuar ndërsa ankuesi pas vizitës mjekësore që dëshmohet përmes Raportit nga Konsulta e Qendrës së Mjekësisë Familjare e datës 05.04.2023 identifikuar me kod: 600272588 dhe Raport për zgjatjen e paaftësisë së përkohshme-pengesës për punë i njëjti është referuar për pushim mjekësorë nga data 05.04.2023 deri me datë 12.04.2023 për shkak të gjendjes shëndetësore, nga rrjedh se ankuesi me datë 05.04.2023 nuk ishte prezent gjatë tërë orarit të punës me për shkak të gjendjes shëndetësore, kurse lidhur me deklaratimet dhe pretendimet e ankuesit për mëngjesin apo fillimin e orarit të punës për atë kohë sa ankuesi ishte në punë, Komisioni Disiplinor me rastin e shqyrtimit të procedurës disiplinore nuk ka arritur të bëjë shqyrtimin dhe verifikimin e fakteve apo verifikimin e ngjarjes qoftë përmes shikimit të kamerave apo verifikimit të formularëve për të cilët ankuesi pretendon se i ka nënshkruar, nga rrjedh se në rastin konkret Komisioni Disiplinor ka vepruar gabimisht kur ia ka falur besimin vetëm deklaratimeve të dhëna të inicuesit të procedurës disiplinore dhe deklaratave të zyrtarëve S. Sh të datës 13.04.2023 dhe S. M të datës 12.04.2023, ngase sipas nenit 12 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.4 dhe paragrafi 4 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative"* Komisioni Disiplinor përveç që merr në pyetje ose merr deklarata nga dëshmitarët ai duhet të verifikoi dhe shqyrtoi të gjitha faktet nëse deklaratimet janë të qëndrueshme për zgjidhjen e çështjes administrative, e që në rastin konkret një veprim të tillë nuk e ka ndërmarr dhe si shkak i kësaj nuk ka arritur të konstatoj drejtë gjendjen faktike apo gjendjen e konstatuar sipas Vendimit të

datës 11.05.2023 nuk e ka mbështetur me prova materiale, prandaj mbi këtë bazë dhe konstatimet e dhëna si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, ankesa e ankuesit është e bazuar.

Prandaj, nga se u tha si më lartë, pas analizimit dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, analizimit të shkresave dhe dispozitave të aplikuara ligjore ndërlidhur me rastin konkret, Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se Vendimi KD.nr.020/2023 i Komisionit Disiplinor i datës 11.05.2023 është akti administrativ i paligjshëm sikurse edhe përcaktohet me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si në vijim: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme," dhe si i tillë vendimi i Komisionit Disiplinor është shfuqizuar sikurse në diapozitivin e këtij vendimi, ndërsa ankesa e ankuesit është aprovuar si e bazuar për shkak të konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, ngase masa e shqiptuar disiplinore nuk përcaktohet me dispozitat e ligjit material, gjegjësisht Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, procedura e zhvilluar administrative nga Komisioni Disiplinor nuk është në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 12 të rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik si dhe nenit 86 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që deri të shqiptimi i masës disiplinore kishte ardhur pa ndërmarr asnjë veprim procedural sipas detyrës zyrtare me qëllim të verifikimit të ngjarjes.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafit 4 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në diapozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.753/2023

**Flakron GASHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

